



PICAC NT

Partners in Culturally
Appropriate Care

Nënshkrimi i kontratës për Shërbimet e Kujdesit në Shtëpi



Albanian - Shqip

Paketa e Kujdesit në Shtëpi (Home Care Package) mund t'ju sigurojë të merrni shërbimet, mbështetjen dhe suportin që ju nevojitet.

Para se ta nënshkruani Kontratën me Ofruesin e Shërbimeve për marrjen e Shërbimeve të Kujdesit në Shtëpi, është e nevojshme që të jeni të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja.

Ju nevojitet të:

1. Kuptoni të drejtat tuaja¹.
2. Keni dijeni që të drejtat tuaja duhet të respektohen nga Ofruesi i Kujdesit tuaj në Shtëpi.
3. Flisni me ofruesin tuaj, nëse keni ndonjë shqetësim të kujdesit.
4. Keni përgjegjësi ndaj Ofruesit të Kujdesit në Shtëpi që zgjidhni.
5. Tregohuni të respektueshëm dhe të vëmendshëm.
6. Siguroni një vend të sigurt (jashtë çdo rreziku) për ofruesit dhe stafin e tyre, për t'ju ndihmuar.
7. Të jeni të gatshëm ndaj ndryshimeve në Paketën tuaj të Kujdesit në Shtëpi nëse shëndeti juaj ndryshon.
8. Paguani tarifat tuaja për Kujdesin në Shtëpi ashtu siç është rënë dakord me ofruesin tuaj.

¹Home Care Packages Program Manual for Care Recipients, (Manuali i Programit të Paketave të Kujdesit në Shtëpi, për marrësit) versioni 1.4, janar 2023

Para se ta nënshkruani Kontratën

Keni të drejta *përpara* se të nënshkruhet ndonjë kontratë. Duhet të keni një kuptim të qartë të kontratës që nënshkruani.

Gjërat që duhet të kontrollohen

	Po	Jo
1. A keni marrë kopjen e kontratës, flëtushkë dhe broshurë për shërbimin e ofruar pa patur fjalët e mëdhaja që përdoren në gjuhën angleze?	☐	☐
2. A keni marrë një kopje në gjuhën shqipe të të gjitha dokumentave të ofruara nga Ofruesi juaj i Shërbimit?	☐	☐
3. A keni marrë një kopje të kontratës (në të dyja gjuhët në atë angleze dhe shqip), të paktën <i>një</i> javë para takimit për nënshkrimin e saj? *	☐	☐
4. A përmban kontrata një listë të qartë të shërbimeve nga Ofruesi i Shërbimit që do t'ju ofrohen kur ta nënshkruani?	☐	☐
5. A përmban kontrata listën e të gjitha shërbimeve të <i>mundshme</i> që mund të ofrohen nga Ofruesi i Shërbimeve, bazuar në vlerësimin tuaj të Kujdesit në Shtëpi, (edhe nëse nuk jeni aktualisht të interesuar për to)?	☐	☐
6. A keni marrë në konsideratë metodën tuaj të preferuar për pagesat e tarifave, (siç janë për shembull: debitimi direkt, zbritjet nga pagesa e Centrelink-ut, apo transfertat mujore)?	☐	☐
7. A ju është ofruar një përkthyes i kualifikuar duke përjashtuar përkthimin nga anëtarët e familjes për përkthime gjatë bisedave me Ofruesin e Shërbimeve?*	☐	☐
8. A keni pasur kohë të shqyrtoni kontratën me Ofruesin e Shërbimeve dhe të merrni përgjigje për të gjitha pyejtjet tuaja?	☐	☐
9. A keni marrë një kopje të Statutit të të Drejtave të Moshuarëve në shqip, jo vetëm në gjuhën angleze?	☐	☐

Nëse jeni përgjigjur 'jo' ndonjëherë prej këtyre pikave, keni të drejtë të pyesni Ofruesit tuaj të Shërbimeve për më shumë informacion.

* Shërbimet profesionale të përkthimit me shkrim dhe gojë janë **falas** si për ju dhe për Ofruesin e Shërbimeve.

Ky botim u krijua nga COTA NT, dhe është mbështetur nga kontributet financiare nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Kujdesit për të Moshuarit. Për një version të modifikueshëm të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni menaxherin e PICAC.